

Më  
Dana

24-05-2017

PKR.39/17

  
NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI PER KRIME TE RENDA**-si gjykatë e shkallës së parë, me kryetaren e trupit gjykues, Hysnije Gashi dhe zyrtaren ligjore, Albana Ujupi, në lenden penale kundër të akuzuarve [REDACTED] dhe [REDACTED] për shkak të veprës penale secili veq e veq, falsifikimi i parasë nga neni 302.2 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj Departamenti per Krime te Renda PP/I nr. 3/17 të datës 08.03.2017 pas mbajtjes se shqyrtimit gjyqësor në prani te Prokurorit te shtetit Rasim Maloku, të akuzuarve [REDACTED], mbrojtësit te tij av. [REDACTED] dhe mbrojtësit te tij av. [REDACTED] me dt. 17.03.2017 shpall dhe publikisht komunikon, ndërsa me datë 28.03.2017 përpiloi me shkrim këtë:

#### A K T G J Y K I M

##### Ndaj te akuzuarve:

I [REDACTED] i lindur me date [REDACTED] ne [REDACTED] i ati [REDACTED] e ëma [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED], me vendbanim ne fshatin [REDACTED], Komuna [REDACTED], i pamartuar, ka te kryer shkollën fillore, me profesion gomister, me nr. personal [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes se mire ekonomike. në arrest shtëpiak nga data 15.01.2017 deri me 01.02.1017, dhe nga 01.02.2017 në paraburgim deri më deri me dt. 17.03.2017

II. [REDACTED] i lindur me datë [REDACTED] ne [REDACTED] i ati [REDACTED] e ëma [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED], me vendbanim ne [REDACTED] rr." [REDACTED], i pamartuar, ka te kryer shkollën fillore, i pa punësuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes se mire ekonomike. në arrest shtëpiak nga dt 15.01.2017 deri me dt. 17.03.2017

## JANË FAJTOR

Sepse me datën 15.01.2017 rreth orës 01:54, ne pompën e derivateve " [REDAKTUAR] " e cila gjendet ne rrugën "Rexhep Bislimi" ne Ferizaj, i pandehuri [REDAKTUAR] ka poseduar para te falsifikuara ne vlere prej 20 euro me numër serik WA1893147823 me qellim qe ti ve ne qarkullim si te vërteta, ne atë mënyrë qe te pandehurit me veturën BMW me numër te targave [REDAKTUAR] te cilën e drejtonte [REDAKTUAR] janë ndalur ne pompën e derivateve " [REDAKTUAR] ", me ç'rast i pandehuri [REDAKTUAR] ia ka dhënë paratë e falsifikuara te pandehurit [REDAKTUAR], i cili ka hyre ne market ku ishte duke punuar [REDAKTUAR] dhe ka blere një pako cigare, një shishe ujë dhe një shkrepsë te gjitha ne vlere prej 2.50€, te cilat i ka paguar me bankënotën e falsifikuar dhe ka marre kusurin prej 17.50€, e pastaj janë larguar me veture, mirëpo pasi qe i dëmtuari ka vërejtur se paratë janë te falsifikuara ka njoftuar policinë, e cila ka arrestuar te pandehurit, me ç' rast gjate kontrollit te veturës në ulësen e mbrapme ku ka qenë i ulur i pandehuri [REDAKTUAR] janë gjetur edhe dy pjese të një kartëmonedhe prej 20 euro, e cila gjithashtu ka qenë e falsifikuar.

- Me këtë kanë kryer secili veç e veç veprën penale falsifikimi i parasë nga neni 302 par.2 te KPRK- së.

Andaj, Gjykata në bazë të nenit të sipër cekur dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 46, 73 dhe 74 75,76, të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPRK-së, i

## GJYKON

Te akuzuarit:

**[REDAKTUAR] DËNIM ME BURG NË KOHËZGJATJE PREJ 4 ( katër) muaj .** Në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 15.01.2017 deri me 01.02.2017, nga data 01.02.2017 koha e kaluar në paraburgim deri me 12.03.2017.

II. ■■■■■ DËNIM ME BURG NË KOHËZGJATJE PREJ 3 (tre) muaj.

Në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 15.01.2017 deri me 17.03.2017.

Koha e qëndrimit ne paraburgim dhe arrest shtëpiak te pandehurave te shpallur fajtor, do t'iu llogaritet ne dënimin kryesor ndërsa pjesa e mbetur do te ekzekutohet pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Obligohen te pandehurit që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 50€ /pesëdhjetë euro/, dhe shpenzimet e procedurës penale ne shumen prej 20€ /njëzetë euro/ secili veç e veç në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Ne pajtim me nenin 302 par.6 te KPK-se, konfiskohen ne mënyrë te përhershme paratë e falsifikuara.

Në bazë të nenit 367 par.1 nënpar.1.2 të KPPK-së, Gjykata me aktvendim të veçantë të akuzuarve ua ka ndërprerë masën e paraburgimit. Dhe arrestit shtëpiak.

### A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore ne Ferizaj, Departamenti për Krime të Rënda ka ngrit aktakuzën PP/nr.3/17 të datës 08.03.2017 kundër të akuzuarve ■■■■■ dhe ■■■■■, për shkak të veprës penale falsifikimi i parasë nga neni 302 par.2 të KPK-së .

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin gjyqësor publik me date 17.03.2017 në të cilën përfaqësuesi i akuzës prokurori i shtetit Rasim Maloku lexoi

aktakuzën e Prokurorisë Themelore ne Ferizaj, Departamenti për Krime të Rënda PP/nr.3/17 të datës 08.03.2017.

**I pandehuri** [REDAKTUAR], ne shqyrtimin gjyqësor me rastin e njoftimit per te drejtën e tij qe te pranoje fajësinë apo te deklarohet i pafajshëm ne kuptim te nenit 325 te KPPK-se, ka deklaruar se e pranon fajësinë per veprën penale falsifikimi i parasë nga neni 302 par.2 të KPK-së.

**I pandehuri** [REDAKTUAR] ne shqyrtimin gjyqësor me rastin e njoftimit per te drejtën e tij qe te pranoje fajësinë apo te deklarohet i pafajshëm ne kuptim te nenit 325 te KPPK-se, ka deklaruar se e pranon fajësinë per veprën penale falsifikimi i parasë nga neni 302par.2 të KPK-së.

Prokurori i shtetit Rasim Maloku ne fjalën përfundimtare deklararon se nga vetë pranimi i fajësisë së të akuzuarve i cili pranim është bërë në mënyrë vullnetare dhe i njëjti përputhet me të gjitha shkresat e lëndës vërtetohet se të akuzuarit kanë kryer veprën penale falsifikimi i parasë nga neni 302par.2 të KPK-së.

Andaj i propozoj Gjykates që të njëjtit t'i shpall fajtor dhe ti dënoj me dënim sipas ligjit, gjithashtu propozoj Gjykates që me rastin e matjes së dënimit për të akuzuarit si rrethanë lehtësuese ta marrë se të njëjtit kanë qenë të sinqertë para gjykatës kanë pranuar fajësinë. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata të merre parasysh edhe rrezikshmërinë e kësaj vepre penale, mënyrën se si është kryer dhe mbi bazën e të gjitha këtyre të njëjtëve t'iu shqiptoj një dënim me të cilën të njëjtit nuk do të kryejnë vepër penale. Gjithashtu propozoj që të konfiskohet kartmonedhatat e sekuestruara.

Gjykata konstatoi se pasi që te pandehurit kane kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, një pranim i tillë është bërë vullnetarisht dhe mbështetet në faktet dhe provat e çështjes e kësaj çështje penale, gjykata konstatoi se janë plotësuar te gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 te KPK-se:

- Të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;
- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht mbrojtja e të akuzuarve në shqyrtimin gjyqësor, deklarata e të dëmtuarit, si dhe fotografitë dhe shkresat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës të gjitha këto të mbledhura në hetuesi.
- të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore;
- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Me qenë se të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj kryetari i trupit gjykues konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Mbrojtësi i të akuzuarit [REDAKTUAR] - av. [REDAKTUAR] ka propozuar që të [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] ti nderpritet masa e paraburgimit me që kanë pushuar arsyet për të cilat është caktuar."

Mbrojtësi i të akuzuarit [REDAKTUAR] - av. [REDAKTUAR] ka deklaruar se i mbrojturi i tij e ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën është ngarkuar sipas aktakuzës nga Prokuroria e shtetit se i akuzuari i parë i cili gjithashtu e pranojë fajësinë i propozojë gjyqësorë që si rrethane lehtësuese të marrë për bazë pranimin e fajësive dhe të i shqiptohet një dënim me i but, duke propozuar që të nderpritet masa e arrestit shtepiak".

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale falsifikimi i parasë nga neni 302par.2 të KPK-së. meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi ne pompën e derivateve " [REDAKTUAR] " e cila gjendet ne rrugën "Rexhep Bislimi" ne Ferizaj, i pandehuri [REDAKTUAR] ka poseduar para te falsifikuara ne vlere prej 20 euro me numër serik WA1893147823 me qellim qe ti ve ne qarkullim si te vërteta, ne atë mënyrë qe te pandehurit me veturën BMW me numër te targave [REDAKTUAR] te cilën e drejtonte [REDAKTUAR], janë ndalur ne pompën e derivateve " [REDAKTUAR] ", me ç'rast i pandehuri [REDAKTUAR] ka dhënë paratë e falsifikuara te pandehurit [REDAKTUAR], i cili ka hyre ne market ku ishte duke punuar [REDAKTUAR], dhe ka blere nja pako cigare, një shishe ujë dhe një shkrepsë te gjitha ne vlere prej 2.50€, te cilat i ka paguar me bankënotën e falsifikuar dhe ka marre kusurin prej 17.50€, e pastaj jane larguar me veture, mirëpo pasi qe i dëmtuari ka vërejtur se paratë janë te falsifikuara ka njoftuar policinë, e cila ka arrestuar te pandehurit, me ç'rast gjate kontrollit te veturës në ulësen e mbrapme ku ka qenë i ulur i pandehuri [REDAKTUAR] janë i ulur i pandehuri [REDAKTUAR] janë gjetur edhe dy pjese të një kartëmonedhë prej 20 euro, e cila gjithashtu ka qenë e falsifikuar.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin [REDAKTUAR] Gjykata vlerësoj rrethanat lehtësuese dhe rënduese te parapara nenit 73,74 dhe 75 aplikoi disozitat për zbutjen e dënimit gjykata bëri zbutjen e dënimit duke marrë rrethanat veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarit, është moshës së re l pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer e që këto rrethana i ndërlidhi me faktin se e pandehuri deri tani nuk ka qenë e dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin [REDAKTUAR] Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73,74 dhe 75 aplikoi disozitat për zbutjen e dënimit gjykata bëri zbutjen e dënimit duke marrë rrethanat veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarit, është moshës së re l pendimin e sinqertë dhe

real për veprën penale të kryer e që këto rrethana i ndërlidhi me faktin se e pandehuri deri tani nuk ka qenë e dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se të akuzuarit në shqyrtimin fillesar kanë bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, obligohen të akuzuarit që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 50€ /pesëdhjetë euro/, dhe shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 20€ /njëzetë euro/ secili veç e veç në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Departamenti për Krime të Renda,

PKR.nr.39/17, Me datë 28.03.2017

Zyrtare ligjore,  
Albana Ujupi



Kryetarja e trupit gjykues,

Hysnije Gashi

**Këshilla juridike:** kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 /pesëmbëdhjete/ ditëve nga dita e pranimi të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate

Ekspeduar me dt. 03.04.2017

- Prokurorit
- Të akuzuarve dhe
- Avokatëve